REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr.3201 prot. Maliq, më 13.6.2025

PROJEKT-VENDIM -Nr.9

Për

" Miratimin e programit buxhetor afat mesëm për vitet 2026-2028"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore* " neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak*", gërma dh, ligjit 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë"* neni 32 *"Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore"*, ligjit 68/2017 *"Për financat e qeverisjes vendore "*, neni 38 *"Programi Buxhetor afatmesëm vendor"* pika 3, udhëzimi nr.8, datë 28.02.2025" *Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028"*, shkresës së Ministrisë së Financave Nr.9739 Prot, datë 18.06.2025 "*Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028"*, propozoj miratimin e këtij projekt – vendimi nga këshilli duke vendosur :

1- Të miratojë Projekt-Buxhetin Afatmesëm për **vitet 2026,2027,2028** për Bashkinë Maliq si më poshtë:

1-Të ARDHURAT

-Buxheti i Pavarur, Transferta e pakushtëzuar, Transerta specifike, Transferta e kushtëzuar në 000/lekë janë:

Viti 2026	1,019,585,053
Viti 2027	1,034,753,821
Viti 2028	1,049,550,322

2 -SHPENZIMET

a-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2026

- Paga + sigurime	580,830,000
- Shpenzime operative	202,970,000
- Për investime	235,785,053
TOTALI	**1,019,585,053**

b-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2027

- Paga + sigurime	581,739,187
- Shpenzime operative	203,570,000
- Për investime	249,444,634
TOTALI	**1,034,753,821**

b-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2028

-Paga + sigurime	585,000,000
-Shpenzime operative	205,600,764
-Për investime	258,949,558
TOTALI	**1,049,550,322**

II-Në hartimin e programit buxhetor afat mesëm për vitet 2026-2028, u morën parasysh mendimet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave .

III-Për paraqitjen e këtij projekt-vendimi dhe dokumentat shoqërues, ngarkohet Drejtori i të Ardhurave, Drejtori i Financës dhe Buxhetit në Bashki.

IV-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

Koncepton: Nëp Finance-Buxheti	G.Mukollari		Dt. 13/6/2025
Pranoi: Përgj Sektori	M.Shaholli		Dt. 13/6/2025
Konfirmoi: Drejtor i Drejtorisë	A.Muka		Dt. 13/6/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

3201

Maliq më 13.6.**2025**

RELACION

''Për përgatitjen dhe miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028''

Të nderuar këshilltarë të Këshillit të Bashkisë Maliq !

Ju bëjmë me dije se duke u mbështetur në ligjin nr.68/2017''*Për financat e qeverisjes vendore''*, në nenin 34 *''vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve''* pika 5 dhe 6, pasi u miratuan me vendimin e këshillit bashkiak nr.10, dt 31.01.2025''*Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2026-2028''* duke marrë parasysh dhe vlerësimet afatmesme të transfertave të përcaktuara në udhëzimin nr.8, dt 28.02.2025*''Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028''* të Ministrisë së Financave , institucioni Bashkia Maliq përgatiti dhe po paraqet për miratim programin buxhetor afatmesëm 2026-2028.

Grupi i punës për përgatitjen e PBA-së 2026-2028 u mbështet në planin e buxhetit 2025 dhe në treguesit pozitivë të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitet e kaluara. Përparësi u është dhënë investimeve në infrastrukturën rrugore, rikonstruksionin e ambienteve të arsimit dhe ujësjellës-kanalizime për të përfunduar punën e nisur në vitet e mëpars hme.

Dokumenti i planifikimit financiar (PBA) 2026-2028 u dorëzua më 1 qershor në Ministrinë e Financave sipas afateve të miratuara në kalendarin vjetor.

Sipas udhëzimit, Ministria e Financave me shkresën nr.9739 prot, datë 18.06.2025, e protokolluar pranë institucionit Bashkia Maliq me nr.3410 prot, datë 23.06.2025, dërgoi mendimet mbi PBA 2026-2028.

Bazuar në rekomandimet e Ministrisë së Financave, projekt-dokumenti i programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 është përgatitur sipas standarteve të përcaktuara nga Ministria e Financave. Për këtë i drejtohemi Këshillit Bashkiak të na miratojë këtë projekt-vendim për përgatitjen dhe miratimin e Projekt-dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Drejtori i Financës dhe Buxhetit
Almira Muka

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al